



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA			
KOMUNA E VITIËS - OPŠTINA VITINA			
Prijava / Primažna Mera/Cana	02-05-2014		
Nr. Orgjani	Numbri Broj	Shtoječ Prilog	Vlera Vrednost
Org.broj			
01-013/595			



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 40.2 pika a dhe nenit 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, gazeta zyrtare nr.28/2008 si dhe nenit 22.2 pargji. 2 të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, lidhur me dispozitat ligjore të Udhëzimit Administrativ nr.05/2013 për transparencë në komunë, kryetari i Komunës së Vitisë në bazë të kompetencave dhe përgjegjësive bien këtë

RREGULLORE mbi Transparencën

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregullore është forcimi i transparencës së organeve të Administratës Komunale përmes rregullave që mundësojnë ushtrimin dhe zbatimin e praktikave më të mira administrative për qasje në dokumente publike.

Neni 2

Fushëveprimi

2. Kjo rregullore rregullon pjesëmarrjen e publikut në mbledhjen e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve, mbledhjet me publikun, detyrimin për njoftim publik, konsultimin e publikut para miratimit të akteve komunale nga organi propozues i aktit, pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes, si dhe qasjen në dokumente publike të komunave të cilat janë të hapura me publikun.

Neni 3

Neni 3

Mbledhjet e Kuvendit Komunal

1. Mbledhjet e Kuvendit Komunal janë të hapura për publikun dhe për përsaqësuesit e mjeteve të informimit publik.
2. Kuvendi i Komunës sipas mundësive buxhetore mund të bëjë transmetim të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.
3. Kuvendi i Komunës nëpërmjet Zyrës për Informim njofton publikun të paktën 7 (shtatë ditë) para mbledhjeve të rregullta ose 3 (tre) ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme. Njoftimi për publik bëhet përmes:
 - 3.1. Shpalljeve publike në vendet me të frekuentuara brenda territorit të komunës;
 - 3.2. Mediave të shkruara dhe elektronike;
 - 3.3. Faqes së internetit të komunës.
4. Njoftimi publik duhet të përbajë:
 - 4.1. Datën, kohën dhe vandin e mbajtjes së mbledhjes;
 - 4.2. Rendin e ditës;
 - 4.3. Materialet e mbledhjes.
5. Kryesuesi i Kuvendit duhet të njoftoi Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal 7 (shtatë) ditë pune para mbajtjes së mbledhjeve të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës.
6. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës ose të komiteteve mund të janë të myllura, pjesërisht ose tërësisht vetëm për shkaqet e parashikuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Kërkesë për informim, iniciativa qytetare dhe peticion

1. Çdo subjekt fizik apo juridik ka të drejtë të parashtroj kërkesë për realizimin e ndonjë të drejtë, iniciativë qytetare dhe peticion për çështje që janë përgjegjës organet e komunës.
2. Kërkesat, iniciativat qytetare dhe peticonet shqyrtohen nga Kuvendi Komunal brenda afatit prej 60 ditëve siç është e përcaktuar në nenin 70 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040.
3. Pas diskutimit në Kuvendin e Komunës njësia/zurtari për komunikim me qytetar jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shqyrtimit njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit.
4. Në raste kur kërkesat për realizimin e ndonjë të drejtë, iniciative qytetare ose peticione lidhen me çështjet për të cilat komuna nuk është drejtë drejt kompetente, kryetari i komunës ose njësia për komunikim me qytetar brenda afatit të përcaktuar njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit se është jokompetente, si dhe procedon atë tek organet kompetente duke e njoftuar edhe parashtruesin e kërkesës.

Neni 5

Tubimet me publik

1. Kryetari i Komunës është i obliguar që të mbajtë paktien dy takime me publikun për çështje të interesit të përgjithshëm, njërin takim në gjashtë mujorin e parë të vitit dhe tjetrin në gjashtë mujorin e dytë.
2. Njëri nga takimet mbahet në gjashtë 6-mujorin e parë të vitit.
3. Përveç dy takimeve Kuvendi i Komunës duhet të shqyrtoj mundësinë për të mbajtur takime shtesë dhe të jetë sa më pranë qytetarëve për çështje lidhur me buxhetin komunal, zhvillimin ekonomik lokal, përdorimin e pronës komunale, planifikimin hapësinorë, investimet, të hyrat komunale, si dhe çështje tjera në interes të përgjithshëm.
4. Komuna siguron hapësirat e mjaftueshme brenda territorit të komunës për pjesëmarrje të gjerë dhe aktive të publikut.
5. Kryetari i Komunës nëpërmjet Zyrës për Informim informon publikun së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit publik.

Neni 6

Konsultimi i publikut para miratimit të akteve

1. Aktet e organeve të komunës, vendimet, rregulloret të cilat janë me interes i nënshtronen diskutimit publik para miratimit. Organi propozues përgatit projekt aktin dhe cakton mënyrën e zhvillimit te konsultimit, asfatit të konsultimit duke përfshirë grupet e interesit, seancat dëgjimore me publikun dhe forma tjera të pjesëmarrjes së publikut.
2. Zyra për Informim e Komunës njofton publikun 14 ditë para seancës se konsultimit publik si më poshtë:
 - 2.1. Shpalljeve publike në vendet me të frekuentuara brenda territorit të Komunës;
 - 2.2. Njoftimi në mediat elektronike dhe te shkruara lokale;
 - 2.3. Njoftimi në Ueb- faqen zyrtare të Komunës.
3. Propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimeve duhet të evidentohen. Propozimet shqyrtohen brenda asfatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga përfundimi i konsultimit.
4. Organi që e ka propozuar aktin duhet të informojë Kuvendin për propozimet e dhëna në diskutim publik duke përfshirë propozimet e refuzuara si dhe ato të marra parasysh. Me rastin e miratimit të aktit Kuvendi kujdeset që propozimet e argumentuara të përfshihen në tekstin përfundimtar të projekt aktit.

Neni 7

Qasje në dokumentet publike

1. Në përputhje me ligjin nr.03/L-215 për qasje në dokumentet publike, organet e Komunës garantojnë qasje në informatë, respektivisht në dokumente publike të personave fizik dhe juridik.
2. Njësia, zyrtari për komunikim me qytetaret bënë pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumentet publike të aprovuara nga organet e komunës dhe adreson në pajtueshmëri me Ligjin nr.03/L-215 për Qasje në Dokumentet Publike.

3. Nëse organet e komunës nuk posedojnë dokumentin e kërkuar nga parashtruesi i kërkesës, atëherë organet e komunës detyrohet që në afat prej 5 ditë pune nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim të ja përejell dokumentin organit gjegjës i cili posedon informatën.
4. Organet e komunës obligohen brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e marrjes se kërkesës të nxjerrin vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japim përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesshëm dhe informon kërkuesin për të drejtën qe ai ka për parashtrimin e një kërkese për rishqyrtim.
5. Në rastet e refuzimit të kërkesës së plotë apo të pjesshme, parashtruesi i kërkesës mundet që brenda 15 ditësh pas marrjes së përgjigjes nga organet e komunës të parashtroj kërkesën për rishqyrtimin e çështjes se kërkuar nga organet e komunës që ta rishqyrtoj vendimin.
6. Afati për realizimin e së drejtës për qasje në dokumentet publike mund të vazhdohet deri në 15 ditë në çoftëse dokumenti publik kërkohet jashtë organeve të komunës dhe nëse përmes një kërkese kërkohen dokumente publike.
7. Ne rast se organet e komunës nuk përgjigjen brenda afatit kohor të përcaktuar parashtruesi i kërkesës ka të drejte të filloje procedurën para institucionit te avokatit të popullit apo institacioneve publike, si dhe gjykatës kompetente.

Neni 8

Plani i veprimit për transparencë në komuna

1. Çdo komunë harton planin e veprimit për transparencë në komunë. Pas hartimit dhe miratimit të planit, Kuvendi i Komunës miraton rregulloren komunale për transparencë në komunë.
2. Planet për transparencë në komuna kanë për synim ti ofrojnë publikut qasje në monitorimin dhe zbatimin e akteve të komunës, duke përfshirë edhe menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive, prokurimit dhe sferave tjera të cilat janë me interes për publikun.
3. Plani mund të përfshijë veprime dhe iniciativa të dizajnuara për të përmirësuar qasjen në dokumentet publike dhe transparencën në komuna.
4. Plani mund të përfshij, si:
 - 4.1. Raportimin më të shpeshtë në media për çështje që lidhën me përdorimin e buxhetit komunal, zhvillimin ekonomik, përdorimin e pronës komunale, planifikimin urban, investimet, të hyrat komunale si dhe çështje tjera me interes të përgjithshëm.
 - 4.2. Mbajtja e konferencave periodike me gazetarët dhe përsaqësuesit e mjeteve lokale të informimit,
 - 4.3. Organizimi i seancave për pyetje me publikun e gjerë ose grupit të interesit për çështje që janë në interes,
 - 4.4. Çdo komunë duhet të zhvilloj dhe mirëmbaj Ueb-faqen zyrtare të saj ashtu siç e përcakton Udhëzimi Administrativ nr.03/2011 për ueb-faqet e institacioneve publike

Neni 9
Përgjegjës për zbatim

I. Kuvendi i komunës dhe kryetari i komunës janë përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 10
Monitorimi

I. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal bënë monitorimin e zbatimit të kësaj rregulloreje.

Neni 11
Hyrja në fuqi

I. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit në kuvend.

Viti, më 21.03.2014

Kryesuesi i Kuvendit

z.Naim Pira

